

**VENDIM**  
**Nr.643, datë 30.9.2004**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.6.1997 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRFITIMIN NGA STATUSI I TË VERBËRIT”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 17 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të përcaktojë çdo vit në buxhetin e saj, si zë të veçantë, një fond për financimin dhe subvencionin e Qendrës Kombëtare të Rehabilitimit të të Verbërve përkatësisht për ngritjen dhe administrimin e kësaj qendre.

Qendra Kombëtare e Rehabilitimit të të Verbërve të ofrojë shërbime deri në vitin 2014.”.

2. Pas pikës 11, të shtohen pikat 11/1 dhe 11/2, me këtë përmbajtje:

“11/1. Qendra Kombëtare e Rehabilitimit të të Verbërve përmbush detyrimet si institucion i posaçëm dhe i specializuar, në ofrimin e shërbimeve të veçanta për të verbërit.

11/2. Përfituesit e pajisur me librezë verbërie paguajnë çdo vit, përkatësisht:

- grupi i parë 6 për qind të masës së pagesës së verbërisë;
- grupi i dytë 5 për qind të masës së pagesës së verbërisë.”.

3. Pas pikës 12, shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë të mbajnë parasysh projektet e Qendrës Kombëtare të Rehabilitimit të të Verbërve në projektet e tyre të zhvillimit, në grantet apo në kreditë e siguruar për këtë qëllim.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**